



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 21
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 11 korrik 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, Drita Millaku, Naser Rugova dhe Flora Brovina.

Të ftuar: Uran Ismaili , ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Pjesëmarrës tjerë: Naim Bardiqi, sekretar i MSH-së, Fatmir Plakiqi, drejtor i Fondit për Sigurimet Shëndetësore, Besianë Musmurati-MSH, Anjezë Gojani-MSH, Gresa Maxhuni-KDI, Besiana Dauti nga Ekonomia Online dhe Bujar Vitija nga Gazeta “Shneta”.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili;**
 - Furnizimi me barna nga lista esenciale,
 - Procesi i revidimit të listës esenciale të barnave,
 - Funkcionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore,
 - Vonesat në procedimin e projektligjeve,
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili;

- Furnizimi me barna nga lista esenciale,
- Procesi i revidimit të listës esenciale të barnave,
- Funkcionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore,
- Vonesat në procedimin e projektligjeve,

Kryetarja, tha se ende në spitalet tona mungojnë barna nga lista esenciale. Për ne është e pajustificueshme një vonesë kaq e madhe në revidimin dhe përpilimin e një liste re për barna esenciale. Te funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, nëse mund të na tregoni se deri ku keni mbërritur sa i përket kësaj çështjeje. Në lidhje me vonesat në procedimin e projektligjeve, ajo tha se në Plan të punës së Komisionit ishin dy projektligje, të cilat nuk kanë ardhur dhe për të cilat ajo kërkoi sqarime nga ministri.

Uran Ismaili, ministër i MSH-së, tha se në sektorin e shëndetësisë ka probleme që janë krijuar me vite të tëra. Nëse flasim për listën esenciale, ne kemi pasur një listë esenciale që na viti 2012 e cila asnjëherë nuk është reviduar. Kemi pasur probleme të mëdha në planifikimin real të shpenzimeve sa i përket barnave dhe po bëjmë përpjekje që të kemi një planifikim real dhe jo historik. Gjithashtu, kemi problem edhe me zinxhirin furnizues brenda spitaleve. Sa i përket revidimit të listës esenciale, pati një vullnet nga të gjithë që të bëhet revidimi i listës esenciale, por nuk kam ndonjë arsye shumë të fortë se pse kjo nuk është bërë deri më tani. Ky proces është shumë sensitiv. Kam dashur të kem një marrëdhënie ndërkombëtare me këtë punë, duke punuar me Organizatën Botërore të Shëndetësisë. Deri tani kemi dërguar emrat për komisione dhe për nënkomisione, që do të marrin pjesë. OBSH-ja në shtator, nga ekspertë ndërkombëtarë, do të mbajë tri workshope.

Në lidhje me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, Ismaili tha se kanë bërë një vlerësim të nivelit të punëtorëve dhe shtoi se kanë fituar një fond prej 300 mijë euro për një projekt të binjakëzimit. Rreth vonesës në procedim të projektligjeve, ai tha që këto janë ligje me shumë rëndësi, të dyja ligjet, Ligji për sigurime shëndetësore dhe Ligji për shëndetësi janë në përfundim e sipër.

Kryetarja, tha më herët është thënë që gjithçka është gati me mbledhjen e premieeve, kurse ajo që po thoni ju është që ky proces është ende larg finalizimit.

Enver Hoti, tha se ajo që po na brengos është se ende po e vazhdoni pozitën e sekretarit me ushtrues detyre dhe mendoj që kjo nuk është në rregull. Ngritja e Sistemit Informativ të Shëndetësisë po shkon ngadalë dhe kjo është shqetësuese.

Hoti tha se e mbështesin e-recetën dhe kjo është një punë e mirë. Kemi informacione që në deponi të spitaleve nuk është gjendja e mirë. Po ashtu, paraqiti shqetësimin për ikjen e kuadrit shëndetësorë nga vendi.

Haxhi Avdyli, theksoi se nuk po shohim një reformë afatgjate që do të duhej të kishte filluar para mandatit tuaj dhe të zgjasë edhe pas për mandatit tuaj. Po merreni më shumë me zgjidhjen e problemeve emergjente. Ai tha se edhe Fondi për Sektorin e Shëndetësisë duhet të rritet, kurse pati kritika edhe për sistemin e SISH-it dhe pyeti ministrin se a ka ndonjë plan të veprimit për dy vitet e ardhshme për sigurimet shëndetësore, dhe se a ka filluar Fondi i Sigurimeve me planifikimin e infrastrukturës teknike dhe humane.

Avdyli, gjithashtu pyeti se si do të rregullohen skemat sociale në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, duke ditur se ka shumë skema sociale.

Time Kadrijaj, tha se shëndetësia nuk është në nivelin e mirë. Ka pritur që kjo pako e ligjeve do ta ndryshojë gjendjen, por që deri tani kjo nuk ka ndodhur. Ajo tha se problematika e çështjes së shëndetësisë nuk është vetëm në një ligj dhe shtoi se qytetarët po ballafaqohen me probleme në të gjitha nivelet, si në nivelin primar, sekondar dhe në atë terciar.

Fikrim Damka, tha se po e sheh që Ministria e Shëndetësisë është në një rrugë shumë të mirë. Ai tha që është i gëzuar që pas 18 viteve në QKUK, një person mund të operohet prej zemrës, dhe ky është një sukses. Ai pyet ministrin për recetat elektronike se a janë barnatoret të gatshme për këtë gjë, si dhe pyeti se a do të eliminohet monopoli i çmimit të barnave.

Bekim Haxhiu tha se nga perceptimi i sotshëm, gjendja nuk ka qenë asnjëherë më keq. Ai tha se te dy pikat e para të furnizimi me barna dhe revidimi i listës esenciale, nota është negative. A është shumë me rëndësi funksionalizimi i SISH-it për të parandaluar malverzimet. Lidhur me insulinën, ka pasur shumë probleme me të cilat është dëmtuar shëndeti i qytetarëve dhe a keni ndërmarrë ndonjë veprim për këtë çështje. Një shqetësim tjetër është për barnat që janë në treg me origjinë nga Kina, India dhe shtetet të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe me të cilat Agjencia për Produkte Medicinale nuk ka marrëveshje për njohjen e certifikatës së marketingut, si po arrin që këto produktet ti blejë vet ministria dhe kush ka besueshmëri për këto barna.

Haxhiu pyeti edhe për aparaturën që është blerë për kardiologji, për të cilën tha se është thënë që në janar do të funksionalizohet dhe tani jemi në korrik, e ajo ende nuk është funksionalizuar. Gjithashtu, Haxhiu kërkoi nga ministri që të funksionalizohet Komiteti i Specializimeve, i cili sië tha ky, është jofunksional gati 9 muaj.

Uran Ismaili, ministër i MSH-së, tha se problemet në shëndetësi nuk janë të një njeriu, por ato janë më të thella, pra janë në sistem. Lidhur me ikjen e kuadrit mjekësor, tha që kjo është një dukuri që është duke ndodhur në të gjithë Evropën. Po ashtu, është akumuluar një dëshpërim ndër vite. Sistem ynë shëndetësor i ka dëshpëruar mjekët tanë gjë që ndikon në këtë dukuri, por ne duhet të punojmë që kjo mos të ndodhë. Ne duhet t'ua kthejmë dinjitetin mjekëve, duke filluar nga pagat e tyre.

Ismaili foli edhe për pritjet joreale të cilat tha se nuk mund ti arrijë, sepse ne duhet të shikojmë se nga po nisemi. Nëse do të kishim një sistem më të mirë, sigurisht që do të kishte edhe rezultate më të mira të punës sonë.

Në lidhje me barnatoret, ai tha që ne ju krijojmë kushte për të hyrë në sistem, mirëpo, është interes i tyre të punojnë gjërat tjera si në aparaturë apo trajnim të stafit.

Ismaili, në fund shtoi që ka shumë probleme në shëndetësi, të cilat nuk do të mund ti përfundojë të gjitha, mirëpo, tha që së paku do të jetë një gjendje shumë më e mirë se sa ka qenë deri më tani.

Naim Bardiqi, tha që sa i përket planifikimit me insulinë, me rritjen e buxhetit për vitin 2018, e kemi bërë sipas planifikimit historik e jo sipas kërkesave reale. Ne varem prej planifikimit që e bëjnë vet institucionet dhe i orientojnë kërkesat tek ne.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU